



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 3.6.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj, Agim Aliu, Doruntinë Maloku dhe Milena Miliçević.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hamit Mjeku- praktikant në Kuvend; Zahir Çerkini- praktikant në Kuvend; Florije Kika-AKP; Florina Merovci-ZPRK; Petrit Hysaj-OSBE; Drilon Asllani-Radio “Dukagjini”; Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office; Ardian Bajraktari-MD; Norë Shabani-“Koha Ditore”; Alma Tafarshiku-EULEX; Armend Zenelaj-BIRN; Valdet Hajdini-IKD; Gentiana Dushi-praktikante; Shkëlqim Hysenaj-KTV; Sabahudin Mema-NISMA.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.4.2015;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë Kosovare për Prona, për vitin 2014;

4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës;
5. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore;
6. Njoftim i Komisionit për punën e grupit punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me propozim të z. Zemaj, që pika e 4-të, të shqyrtohet para pikës së 3-të dhe pika 5, hiqet nga rendi i ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.04.2015,

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.4. 2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës

Kryetarja- Theksoi se kjo është hera e katërt që po diskutohet për këtë çështje në Komisionin për Legjislacion dhe është shumë e padrejtë që ende nuk është formuar Komisioni për dhënien e provimit të Jurisprudencës, për arsye që shumë kandidatë po presin të hyjnë në këtë provim dhe është e padrejtë karshi tyre të ketë pengesa për formimin e Komisioni për dhënien e provimit të Jurisprudencës. Komisioni për Legjislacion ka kërkuar sqarim nga ministri i drejtësisë, por ministri nuk është përgjigjur fare, madje as për informatë se, pse anëtarët që janë propozuar janë në shpërputhje me Ligjin për provimin e jurisprudencës. Andaj, e kam vendosur në rend dite, që t'i rekomandojmë seancës, që anëtarët të cilët i plotësojnë kriteret, sipas Ligjit për provimin e jurisprudencës, të rekomandohen për seancë, ndërsa të tjerët jo, sepse të paktën janë dy anëtarë të propozuar këtu që nuk i plotësojnë kriteret sipas Ligjit për provimin e jurisprudencës.

Armend Zemaj- Theksoi se kjo çështje nuk duhet të zgjatet më shumë, për hir të studentëve, sepse tanimë ka kaluar edhe afati i dytë që po humbet. Shihet qartë se Ministria e Drejtësisë qëndron prapa këtij propozimi të anëtarëve të provimit të jurisprudencës, andaj propozoi që lista me kandidatë të shkojë në seancë për miratim, kështu siç është, pa asnjë ndryshim dhe Qeveria ta arsyetojë para të gjithë deputetëve.

Kryetarja- Tha se nuk mund t'i rekomandojmë seancës që t'i përkrahin personat që janë në shpërputhje me Ligjin për provimin e jurisprudencës, andaj duhet ta procedojmë për seancë, por jo të rekomandojmë që t'i votojnë të gjithë kandidatët.

Selvije Halimi- Tha se problem më i madh është që po lejojmë dispozita në brendinë e ligjit, që janë ndesh me frymën e ligjit ose qëllimin e ligjit, sepse më pas kjo na nxjerr telashe. Është e qartë se dy anëtarë të propozuar, nuk kanë provojë të mjaftueshme në sistemin e drejtësisë, mirëpo pasi që ministri ka qenë i zënë e të vijë sot këtu, atëherë propozoj që ta dërgojmë në seancë dhe atje t'i kërkojmë sqarim ministrit.

Kryetarja- Tha se i kemi lënë kohën në diskrecion të ministrit, se kur ai mund të vijë e të na informojë për këtë çështje, të paktën 10 minuta, të tregojë se pse Qeveria ose Ministria e Drejtësisë, e ka shkelur ligjin, por ai nuk ka gjetur kohë të vijë dhe të na tregojë për këtë çështje. Pra, ministri nuk ka gjetur kohë, andaj nuk duhet humbur më kohë dhe t'ia procedojmë seancës, duke informuar se dy nga anëtarët e propozuar, nuk i plotësojnë kriteret.

Agim Ademaj- Theksoi se po humbet tepër kohë rreth kësaj çështjeje, andaj duhet proceduar për seancë, duke njoftuar se dy nga anëtarët e propozuar, nuk i plotësojnë kushtet në bazë të ligjit, e në seancë ta pyesim ministrin për këto propozime, e më pas seanca është ajo që vendos.

Armend Zemaj- Tha se duhet kërkuar në të ardhmen një interpretim për fushën e drejtësisë dhe sistemin e drejtësisë, që herëve tjera mos të ketë kesi lloj vonesash.

Kryetarja- Tha se duhet pasur 12 vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë që nënkupton gjyqësi, prokurori, avokati, se kështu e thotë kapitulli i Kushtetutës për sistemin e drejtësisë.

Selvije Halimi- Propozoi që rekomandimi të jetë për secilin veç e veç, në bazë të përvojës së punës, ndërsa për dy kandidatë që kanë provojë 12 vjeçare në fushën e drejtësisë, gjatë diskutimeve në seancë, i paraqesim këto, e më pas Qeveria jep mendimin e vet.

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se Visar Morina ka dhënë dorëheqja nga zëvendësi dhe këtë e ka bërë me shkrim pranë Komisionit.

Selvije Halimi- Theksoi se fusha e drejtësisë është mjaft e gjerë dhe vetë sistemi i drejtësisë buron nga kjo fushë, andaj pikërisht prej faktit se ata anëtarë që janë profesorë, kanë kaluar 12 apo më shumë gjenerata në fushën e drejtësisë, nuk duhet të shkojë rekomandimi për në seancë nga Komisioni, se ky apo ai e plotëson atë kriter, sepse opinioni i kupton gjërat, ashtu siç thuhet, e jo ashtu siç rrjedh procesi dhe nuk dua të jem pjesë e një dokumenti të shkruar ku diskreditohen emrat e profesorëve tanë, që vërtet janë profesionalë, andaj ta dërgojmë në seancë që ta shqyrtojmë.

Pas diskutimeve, Komisioni, me 6 vota për dhe 1 kundër, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet propozim-vendimi i Ministrisë së Drejtësisë, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës, me anëtarët dhe zëvendësit e tyre.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare për Prona, për vitin 2014

Në shqyrtimin e raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare për Prona, për vitin 2014, ishte ushtruesja e detyrës së zëvendës drejtorit të Agjencisë Kosovare për Prona, **Florije Kika**.

Florije Kika- Paraprakisht, tregoi se nga 29 korriku i viti 2014, është ushtruese e detyrës së zëvendës drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Pronës, pasi që zëvendës drejtori kishte dhënë dorëheqje dhe tregoi se zëvendës drejtori dhe drejtori propozohen nga kryeministri dhe zgjidhën nga Kuvendi, dhe për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, unë jam emëruar nga Bordi dhe jo nga Kuvendi.

Agjencia Kosovare për Prona, është agjenci e pavarur, e themeluar në bazë të Rregullores 2006/10, Rregullores së UNMIK-ut, e ndryshuar më pas me Rregulloren 2006/50 për zgjedhjen e kërkesave pronësore private, që kanë të bëjnë me pronën bujqësore dhe atë komerciale që janë rezultat i luftës që ka ndodhur në Kosovë, dhe me vonë, kjo rregullore është ndryshuar me Ligjin nr. 03\ L-079 dhe mandati i Agjencisë është t'i zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me kontestet pronësore private gjatë periudhës së luftës. Sa i përket mandatit të Agjencisë, janë bërë disa ndryshime në legjislacion, kryesisht me Ligjin nr. 04\ L 115, por nuk ka të bëjë me mandatin konkretisht, por vetëm për shkak të emërimit në disa pozita, ku janë paraparë pozitat ndërkombëtare të pushojnë së vepruari në fund të gushtit, ndërsa sa i përket mandatit, s'ka pasur ndonjë ndryshim ligjor. Agjencia është e përbërë prej tri organeve kryesore:

- 1) Sekretaria kryesore; 2) Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës; dhe, 3) Bordi Mbikëqyrës.

Sekretaria ka kompetenca që t'i pranojë, regjistrojë dhe t'i verifikojë dokumentet, t'i përpunojë kërkesat dhe t'ia referojë Komisionit për vendimarrje.

Komisioni për Kërkesa Pronësore ka kompetencë që t'i zgjidhë të gjitha këto kërkesa, dhe deri në dhjetor të vitit të kaluar, janë vendosur ndërsa sa i përket këtij mandati, Agjencia ka përfunduar mandatin për vendosjen e këtyre kërkesave, e që në total janë 42 749 kërkesa.

Bordi Mbikëqyrës ka kompetencë që të mbikëqyrë punën e Agjencisë, të udhëzojë për politika të ndryshme dhe assesi mos të ndikojë në vendosjen e kërkesave gjatë shqyrtimit nga ana e komisionit. Bordi përbëhet prej 5 anëtarëve, ndërsa për momentin janë të emëruar 3 anëtarë ndërkombëtarë, të cilët janë emëruar nga përfaqësuesi special. Këta tre ndërkombëtarë janë emëruar në përputhje me Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, pra ratifikimin e kësaj marrëveshjeje mes Kosovës dhe Bashkësisë Evropiane, ndërsa anëtarëve vendorë iu ka skaduar mandati në nëntorin e kaluar, dhe deri më tani, ende nuk janë propozuar dhe emëruar nga Kuvendi. Pra, për momentin, Sekretaria dhe Bordi janë jofunksionalë.

Përveç mandatit kryesor, Agjencia ka mandat të bëjë edhe zbatimin e vendimeve dhe gjithashtu një mandat të trashëguar nga Drejtoria për Çështje Pronësore, është mandati për zbatimin e vendimeve të pazbatuara nga ajo drejtori dhe administrimin e pronave, të cilat kanë qenë në administrimin e asaj drejtorie.

Sfidat e Agjencisë janë të ndryshme, duke u nisur nga mungesa e drejtorit dhe zëvendës drejtorit, po ashtu jo-qëndrueshmëria financiare, humbja e stafit profesional, gati mbi 20 pozita kanë dhënë dorëheqje për shkaqe të financimit, sfida tjetër është kompensimi i skemës së qirasë, kompensimin e rasteve që janë trashëguar nga Drejtoria për Çështje Pronësore e Banësore, kanë kaluar me vite dhe këto vendime janë të pazbatuara, sepse nevojiten 3.2 milionë euro. Kurse sa i përket zbatimit të vendimeve, edhe kjo është një sfida në vete, sidomos veprimi në pjesën veriore

të Mitrovicës, pavarësisht se prej vitit 2011, deri në mars të vitit 2014, dëbimet janë ndaluar në atë pjesë, por pas krijimit të Drejtorisë Rajonale të Mitrovicës, Agjencia ka filluar të veprojë edhe në atë pjesë. Janë përfunduar 7 dëbime gjatë vitit 2014, por veriu ende mbetet sfidë. Sfidë tjetër është edhe mosmiratimi i Ligjit për verifikim dhe krahasim të pronës. Në këtë ligj është paraparë që një pjesë e mandatit të trashëgohet dhe njëkohësisht të transformohet në një agjenci të re.

Kryetarja- Projektligji për themelimin e Agjencisë për Verifikim të Pronës, që ka kaluar në parim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo do ta thërrasim Edita Tahirin, që është edhe përgjegjëse kryesore e marrëveshjes për kopjet e regjistrave të kadastrave pranë Komisionit për Legjislacion, që ta arsyetojë këtë projektligj. Unë i mbroj qëndrimet e mia dhe të Vetëvendosjes, që një ndër elementet kryesore të pavarësisht të vendit, është edhe procesi i dekolonizimit, që nënkupton të drejtën e një populli që t'i kthehet prona. Si çështje që më intereson ta di është se çfarë po bëhet me 11 564 shqiptarë të dëbuar nga veriu i Mitrovicës në shkurt të vitit 2000, pra çka po bëhet me pronat e atyre qytetarëve shqiptarë?

Selviqe Halimi- Theksoi se ka analizuar raportin e punës të Agjencisë dhe ka informacione për punën e Agjencisë, mirëpo jemi në një pozitë ku kemi përballë një person që është ushtruese e detyrës së zëvendës drejtorit dhe nuk do ta ngarkoj me pyetje, por të gjitha shqetësimet do t'i adresoj në Kuvend. Kërkoi nga Qeveria që të përshpejtojë procedurat e përzgjedhjeve, me qëllimin më të mirë që të përzgjidhen personat adekuatë për pozitën në fjalë.

Armend Zemaj- Theksoi se edhe në raportin e vitit 2014, shihet se misioni i Agjencisë, nuk ka arritur shumë suksese në rikthimin e pronave të uzurpuara, andaj duhet të dimë se ku po ngecim, a po ngecim në gjykata apo në Policinë e Kosovës, apo me rivendosjen e këtyre vendimeve të Agjencisë? Dihet problematika në pjesën veriore, që ka të bëjë me rikthimin e shqiptarëve, por edhe në pjesë të tjera që kanë të bëjnë me rikthimin e pronave të çdo individit, qoftë edhe pronat e serbëve, andaj dëshirojmë të dimë se sa personave iu ka kthyer prona dhe sa po funksionon ligji, a po funksionon lidhja me policinë, sipas memorandumit të vitit 2013. Po ashtu, dëshirojmë të dimë dallimin mes 2013 dhe 2014, sipas jush qoftë dëbim apo kthimin e pronave tek pronarët e tyre.

Danush Ademi- Theksoi se shumë prona të komunitetit RAE, janë të uzurpuara dhe problemi është se vetë pronarët nuk posedojnë dokumentacion të plotë të pronave, për arsye se ata i kanë trashëguar dhe nuk i kanë kompletuar dokumentet e nevojshme për vërtetësinë e pronës së tyre, andaj këta persona nuk po mund t'i rikthejnë pronat e tyre dhe shpesh po detyrohen që uzurpatorit t'ia shesin pronën e tyre për një çmim tepër të ultë, ndërsa vetë të mbesin rrugëve apo me qira. Pyetja ime është se a ka ndërmarrë ndonjë hap Agjencia për këtë problem të komunitetit RAE?

Agim Ademaj- Theksoi se janë evidente problemet me prona dhe është e natyrshme se sa herë bëhet fjalë për prona, të shfaqen probleme rreth pronarëve legjitimë. Në trajtimin e pronarëve të banesave, ka pasur shkelje të mëdha nga ana e Agjencisë, sepse shumë njerëz janë detyruar të dalin në rrugë, për shkak se me një vërtetim të pabazuar apo me një letër, janë bërë pronarë të

banesave. Kjo Agjenci dihet se është në fund të mandatit të saj, andaj a jeni të përgatitur që ta përfundoni, sepse shumë herë keni deklaruar që jeni në përfundim, por në anën tjetër ju keni vazhduar të merrni donacione dhe të vazhdoni me të njëjtat çështje. Po ashtu, ka pasur ngecje në bashkëpunim me institucionet lokale, në veçanti po flas për Komunën e Istogut. Atje ka shumë banesa që ka mundësi të barten në menaxhimin e komunës, por Agjencia s'e ka bërë një gjë të tillë, edhe pse ka qenë kërkesa. Krejt në fund, si e ka paraparë Agjencia përfundimin e mandatit të saj apo bartjen në një agjenci të re, që po përgatitet të krijohet? Nuk duhet harruar vështirësitë që kanë mundur të paraqiten dhe mungesën e ligjit, por edhe në zyrat rajonale ka pasur staf tepër të papërgjegjshëm dhe që për një dokument të thjeshtë, kanë maltretuar qytetarët. Pra, qoftë edhe për një informatë të thjeshtë, qytetarët është dashur të presin me ditë të tëra.

Kryetarja- Theksoi se vetë fakti se 90% e 42000 rasteve, sa i keni në tërësi, janë të serbëve. Kjo lë të nënkuptohet se fare nuk trajtohen rastet e pronave të shqiptarëve. Kjo është për keqardhje, për arsye se prona është e shenjtë dhe të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, e jo të ketë diskriminime, sikurse me veriun, ku 11564 shqiptarë janë dëbuar e larguar nga puna, e si pasojë, i kanë humbur edhe pronat, pra fare nuk jeni marrë me trajtimin e këtyre rasteve. Ky është edhe shqetësimi im dhe të gjitha shqetësimet tjera do t'i paraqes në seancën plenare.

Florije Kika- Theksoi se në parim pajtohet me mendimet e anëtarëve të Komisionit, por është një ngatërrim apo moskuptim i mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës, sepse ju po e ngatërroni me çështjet e problemeve pronësore në përgjithësi. Pra, Agjencia ka mandat t'i zgjedhë kërkesat, kontestet pronësore private për pronat komerciale apo ato bujqësore, të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 98/99. Agjencia nuk është se nuk është interesuar për pronat e shqiptarëve, sepse ajo nuk bën dallime se a është prona e shqiptarëve, serbëve, romëve apo dikujt tjetër. Agjencia ka raste dhe kërkesa që vetë palët i paraqesin. Pra, Agjencia nuk bën mbledhje të kërkesave, por i pranon nga palët. Pra, pala ka konsideruar që ka kontest dhe ka paraqitur kërkesën dhe ne veprojmë në bazë të këtyre kërkesave. Ne kemi mandat që t'i zgjidhim këto konteste për periudhën 98/99. Po ashtu, Agjencia ka mandat edhe për pronat e paluajtshme gjatë këtij mandati, por Agjencia asnjë njeri nuk mund ta ndalojë që t'u drejtohet edhe gjykatave kompetente për ndonjë rast. Agjencia ka qenë e gatshme të merret edhe me rastet e veriut, por nuk kemi mundur të veprojmë në veri, sepse as policia nuk ka mundur të veprojë në veri. Memorandumi me policinë, respektohet nga marsi i vitit 2014. Pas kësaj periudhe, në bashkëpunim me policinë, edhe ne kemi vepruar në veri. Një statistikë për vitin 2014, sa i përket veriut, janë angazhuar 86 dëbime, prej tyre janë kryer 7 dëbime, kurse në pjesën jugore janë dëbuar 157 nga gjithsej 160 angazhime për dëbim. Ne kemi marrë obligim nga bashkësia ndërkombëtare, e jo nga Qeveria dhe këto obligime që i kemi marrë rreth kontesteve pronësore. Ne kemi arritur që ta përmbushim këtë obligim. Në lidhje me pronat në Deçan, ka vendosur komisioni që shqyrton kërkesat, duke i shqyrtuar të gjitha dokumentet dhe provat, e nëse mendoni për Drejtorinë për Çështje Pronësore, duhet bërë një dallim, sepse këtu po ngatërrohet dhe shumëkush po mendon se çfarë ka bërë kjo drejtori e çfarë ka bërë Agjencia. Drejtoria ka pasur mandat për të kthyer vetëm të drejtën e posedimit, jo të drejtën e pronësisë. Pra, vetëm e ka

rikthyer gjendjen qysh ka qenë më herët, ndërsa Agjencia ka mandat edhe që ta njohë të drejtën e pronësisë, nëse palët e provojnë që e kanë atë të drejtë.

Agim Ademaj- Tha se në Istog janë disa raste me banesa, ku uzurpatorët kanë qëndruar për një periudhë të shkurtër dhe kanë arritur t'i paguajnë për dy tre muaj faturat e rrymës, ujit etj. dhe me ato fatura janë bërë thujse pronarë dhe tani ata uzurpatorë marrin qira. Për këto raste, komuna ka kërkuar që të barten nën menaxhimin e saj, por Agjencia nuk ka reaguar fare.

Florijs Kika- Tha se Agjencia ka trashëguar nga Drejtoria për Çështje Pronësore e Banesore edhe pronat e braktitura dhe për to ceket edhe në raport se janë 314 prona që nuk i dihet pronari, por ne i mbajmë në administrim, dhe nga viti 2009, mundohemi maksimalisht që t'i gjejmë pronarët e tyre e t'ua kthejmë pronat e tyre. Nga 314 prona që nuk iu dihet pronari, ne kemi arritur që 15 nga to të ua kthejmë pronarëve të tyre, që kanë arritur të vërtetojnë se janë pronarë të atyre pronave. Pra, në qoftë se komuna nuk e dëshmon se këto prona nuk janë të atyre, atëherë ne nuk mund t'ia kthejmë në posedim ato prona komunës, sepse kemi mandat që t'i menaxhojmë. Kurse mjetet e qirasë që i merr Agjencia, i mban në fondin e mirëbesimit, deri në momentin kur paraqiten pronarët legjitimë apo ata që kanë të drejtë posedimi, dhe më pas, ato mjete ua kthejmë në xhirollogarinë e pronarëve legjitimë apo atyre që kanë dëshmuar se kanë të drejtë për posedim.

Agim Ademaj- Pse atëherë disa banesa që janë të uzurpuara në Istog, nuk i janë kthyer në posedim komunës, kur komuna e ka dëshmuar se ata janë uzurpatorë?

Florijs Kika- Tha se është marrë një vetëbesim se Agjencia punon në baza etnike, mirëpo nuk është ashtu, sepse ne veprojmë në bazë të kërkesave të palëve.

Kryetarja- Para lufte, 90% ishin shqiptarë, por si është gjendja tani? Po ashtu, po thuhet se kjo çështje është sfidë, andaj çfarë duhet bërë që mos të jetë sfidë?

Florijs Kika- Tha se Agjencia vepron në bazë të kërkesave, dhe deri më tani, policia nuk na ka asistuar në veri. Më tregoni, si mund të shkojë Agjencia për të kryer dëbimin nga ajo pjesë kur nuk asiston Policia?

Nezir Çoçaj- Theksoi se ka mjaft probleme, shembull ka banesa që u janë dhënë shqiptarëve në kohën e ish-Jugosllavisë, mirëpo më vonë i kanë dëbuar dhe ato banesa u janë dhënë serbëve, andaj tani Agjencia, dhe ka raste kur edhe Gjykata ka vendosur që t'i kthehet banesa në posedim një paramilitari serb, e jo shqiptarit që ka qenë poseduesi i parë.

Florijs Kika- Komisioni ka vendosur që t'u njihet e drejta shqiptarëve që kanë pasur dokumente, para se të dëbohen, kurse serbëve t'u bëhet kompensimi. Janë 143 raste që nuk kemi mundësi t'i zbatojmë, sepse nuk kemi mjete të aprovuara nga Qeveria për 3 milionë e 200 mijë euro.

Nezir Çoçaj- Kërkoj nga kryetarja e Komisionit, që të ftohet edhe përfaqësuesi i huaj që është në Bord, që të japë përgjigje.

Kryetarja- Pas diskutimeve, theksoi se sipas qëndrimit të saj, karshi raportit të AKP-së, nuk e përkrah, sepse nuk paraqet gjendjen reale të Kosovës dhe do të votojë kundër.

Komisioni, me 5 vota për, 2 vota kundër dhe 1 abstenim, nxori këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti i punës së Agjencisë Kosovare për Prona, për vitin 2014.

5. Njoftim i Komisionit me punën e grupit punues për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetarja- Theksoi se duhet proceduar kjo çështje në ditët e ardhshme, sepse veç është themeluar grupi punues më herët, andaj nuk duhet vonuar më shumë. Ajo kërkoj nga kryesuesja e grupit, që ta procedojë projektligjin.

Selvije Halimi- Këtë nismë e kemi marrë me propozimin e Avokatit i Popullit për largimin e një afati për ngritjen e ankesave. Kërkesa e avokatit është mirëpritur dhe kemi marrë mendimet e ndryshme. Për nismën që po e marrim si Komision, duhet njoftuar Qeverinë, e më pas të mbajmë dëgjim publik, pastaj Komisioni të marrë vendim. Ajo ftoi anëtarët e grupit, që më datën 5.6.2015, të mbajnë takimin për këtë projektligj.

6. Të ndryshme

Për këtë pikë, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
